



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



**RREGULLORE Nr. 12/2020
PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJIT NË
KOSOVË**

Qershor 2020

PËRMBAJTJA

KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	4
Neni 1 Qëllimi	4
Neni 2 Fushëveprimi.....	4
Neni 3 Përkufizimet.....	4
KREU II: POLITIKAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE	7
Neni 4 Politikat Tarifore	7
Neni 5 Parimet/kushtet për përcaktimin e tarifave	8
Neni 6 Konsultimi, publikimi dhe rishikimi i politikave tarifore	8
Neni 7 Procedurat për përcaktimin e tarifave.....	9
Neni 8 Faturimi i konsumatorëve.....	9
Neni 9 Kostot operative	9
KREU III INVESTIMET KAPITALE DHE RAPORTIMI	10
Neni 10 Stimulimi i ofruesve të shërbimeve përmes investimeve kapitale	10
Neni 11 Ndikimi i investimeve në tarifa dhe niveli i shërbimit	10
Neni 12 Raportimi	11
KREU IV MENAXHIMI I HUMBJEVE TË UJIT	11
Neni 13 Stimulimi i zvogëlimit të humbjeve.....	11
Neni 14 Monitorimi i humbjeve të ujit.....	12
Neni 15 Kërkesat për Informacion	12
Neni 16 Aplikacioni për Tarifat e Shërbimit	13
Neni 17 Shqyrtimi i Aplikacionit	13
Neni 18 Dokumentet e aplikacionit për shqyrtim	14
Neni 19 Shqyrtimi i Tarifave	14
KREU V: DISKUTIMET ME PUBLIKUN.....	15
Neni 20 Vendimi për Zhvillimin e Diskutimeve me Publikun	15
Neni 21 Organizimi i Diskutimeve me Publikun	15
Neni 22 Prezantimi për nivelin e ri tarifor.....	15
Neni 23 Njoftimi për Diskutimin me Publikun.....	16
Neni 24 Procedurat e Zhvillimit të Diskutimeve me Publik.....	16
Neni 25 Rregullat e Zhvillimit të Diskutimit Publik.....	16
Neni 26 Transkriptimet.....	17
Neni 27 Dokumentacioni.....	17
Neni 28 Raportimi	17
KREU VI: PROCEDURAT E APROVIMIT DHE KORRIGJIMIT TË TARIFËS	17
Neni 29 Aprovimi i Tarifave të Shërbimit	17
Neni 30 Korrigjimet e rregullta të Tarifave të Shërbimit.....	18
Neni 31 Korrigjime të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit.....	18
Neni 32 Procedurat e Aprovimit për Korrigjimet e Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit..	18
Neni 33 Refuzimi i Korrigjimit të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit.....	19
KREU VII: MARRËVESHJET PËR TARIFAT E SHËRBIMIT	19

Neni 34 Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit.....	19
Neni 35 Negocimi për Marrëveshjen e Tarifave të Shërbimit.....	20
Neni 36 Lidhja e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit	20
Neni 37 Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit	21
Neni 38 Pajtueshmëria me Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit	21
KREU VIII: PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT.....	22
Neni 39 Prezantimi i tarifave të shërbimit	22
Neni 40 Publikimi dhe shpërndarja e listës së tarifave të shërbimit.....	22
KREU IX: ZBATIMI, RAPORTIMI DHE ANKESAT	22
Neni 41 Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimit	22
Neni 42 Raportet dhe mbajtja e shënimeve	23
Neni 43 Ankesat	23
KREU X: DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE	24
Neni 44 Gjuha Zyrtare	24
SHTOJCAT	25

Në mbështetje të nenit 4, nën paragrafi 3.6, nenit 19, paragrafi 3 dhe nenit 47, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit nxjerr:

RREGULLORE NR. 12/2020 PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJIT NË KOSOVË

KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të krijojë rregulla dhe procedura sipas të cilave përcaktohen, shqyrtohen dhe zbatohen tarifat për shërbimet e furnizimit me ujë, grumbullimi, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura, dhe furnizimi i ujit me shumicë.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga Autoriteti dhe të gjithë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujës-jellësit, ujërave të ndotura dhe furnizimit të ujit me shumicë në Kosovë.

Neni 3 Përkufizimet

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore do kenë kuptimet si në vijim:
 - 1.1. **Autoritet**- Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) si autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesit të shërbimeve në Kosovë;
 - 1.2. **Aplikacioni për Tarifat e Shërbimit** - dokumenti i dorëzuar Autoritetit nga ofruesit e shërbimeve, në formatin e përcaktuar nga Autoriteti kohë pas kohe;
 - 1.3. **BRR** – Baza Rregullatore e Aseteve sipas udhëzimeve të kontabilitetit rregullator;
 - 1.4. **Ditë Pune** - çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ditë tjetër që është festë zyrtare në Kosovë;
 - 1.5. **Furnizues i Ujit me Shumicë** – çdo ofrues i shërbimit që ka licencë të shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të përpunuar ose të papërpunuar;

- 1.6. **Furnizimi dhe Shitja e Ujit me Shumicë** – personi ose subjekti ligjor i cili blen Ujin me Shumicë nga ofruesi i shërbimeve për qëllime të ri-shitjes së tij tek pala e tretë;
- 1.7. **Kategoria e konsumatorëve**- kategoria e konsumatorëve të definuar si në vijim:
 - 1.7.1. **Konsumator shtëpiak** – konsumatori i klasifikuar nga ofruesi i shërbimeve si konsumator, i cili shfrytëzon shërbimet në banesën e tij apo saj për nevoja të amvisërisë;
 - 1.7.2. **Konsumator komercial/industrial** - personi, subjekti ligjor ose organizata afariste e klasifikuar nga Ofruesi i shërbimeve si konsumator i cili shfrytëzon shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
 - 1.7.3. **Konsumator institucional**- subjekti ligjor i klasifikuar nga ofruesi i shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë e interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Ligjin Për Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123;
- 1.8. **Kërkesa e të Hyrave** - shuma e parave të nevojshme për mbulimin e kostove për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura ose furnizimit të ujit me shumicë të llogaritura në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje;
- 1.9. **Kostot Operative**- kostot racionale dhe të nevojshme që lidhen me funksionimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të trajtimit të ujit dhe ujërave të ndotura, rezervuarëve, puseve, pompave, linjave transmetuese dhe atyre shpërndarëse, objekteve tjera të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, dhe shpenzimet për shërbimet e konsumatorëve, si dhe ato të administratës së përgjithshme;
- 1.10. **Kthimi në Kapital** – kthimi i bazuar dhe i arsyeshëm në vlerën e investimeve të bëra nga ofruesi i shërbimeve ose pronari/ët e tij;
- 1.11. **Lista e Tarifave të Shërbimit** - të gjitha tarifat e zbatueshme të shërbimit për zonën e shërbimit sipas llojit të shërbimit, lokacionit dhe kategorisë së konsumatorëve dhe tarifat për shërbimet e udhe ujërave të ndotura që janë aprovuar nga Autoriteti;
- 1.12. **Ofrues i shërbimeve** - çdo person juridik i regjistruar që ka aktivitet primar, ofrimin e shërbimeve të ujit;
- 1.13. **Personi** - person fizik apo juridik i cili mund të jetë publik apo privat;
- 1.14. **Politika Tarifore** - politika e autoritetit rregullator e cila vendosë parimet mbi të cilat përcaktohen tarifat e shërbimit;
- 1.15. **Shërbimet e Ujit** – shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizimi i ujit me shumicë;

- 1.16. **Shërbimet e Kanalizimit** - shërbime në infrastrukturën fizike, të cilat shërbejnë për të përcjellë ujërat e ndotura;
- 1.17. **Shërbimet e Ujërave të Ndotura** – grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesi shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;
- 1.18. **Shërbimet e Ujësjiellit** – marrja, përpunimi dhe shpërndarja e ujit për konsum njerëzor, si dhe operimi i rrjetit dhe objekteve për këtë qëllim;
- 1.19. **Shërbimet e Ujit me Shumicë të pa Përpunuar** – shërbim për ujin e mbledhur, ose të ekstraktuar, i cili si i pa përpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.20. **Shërbimet e ujit me shumicë të përpunuar** – shërbim i ujit të mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i përpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.21. **Shpenzimet Kapitale**- shpenzimet që shkaktohen lidhur me investimet në asetet fikse me jetëgjatësi më shumë se një vit, duke përfshirë pa kufizim edhe shpenzimet e llogaritura të amortizimit dhe zhvlerësimit gjatë jetëgjatësisë së cilitdo aset fiks të dhënë, të klasifikuar si pronë, stabiliment ose pajisje;
- 1.22. **Struktura e Tarifave** - elementet specifike të tarifave të shërbimit përfshirë bllok - tarifatat, komponentët fikse të tarifave, taksat e lidhjes dhe hollësitë tjera lidhur me aplikimin e tarifave të shërbimit që janë aprovuar nga Autoriteti;
- 1.23. **Taksa për lidhjen e autorizuar** - taksat e Ofruesit të Shërbimeve për sigurimin e lidhjeve të reja (ose ri-lidhjeve) në shërbimet e furnizimit me ujë ose shërbimet e ujërave të ndotura, siç janë të aprovuara nga Autoriteti;
- 1.24. **Tarifa e Shërbimit** - vlera, ngarkesa apo tarifa fikse të Ofruesit të Shërbimeve me të cilat ofruesi i shërbimeve e ngarkon konsumatorin në lidhje me ofrimin e shërbimeve;
- 1.25. **Uji me Shumicë** – uji i përpunuar ose i papërpunuar i cili furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.26. **Urdhëresa Tarifore e Shërbimit** - dokumenti me shkrim, i lëshuar nga Autoriteti ku janë të përfshira të gjitha tarifatat e shërbimit për zonat e shërbimit sipas llojit, lokacionit dhe kategorisë së konsumatorëve;
- 1.27. **Zona e shërbimit**- zona e shërbimit, e cila është përcaktuar me aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria e Kosovës
- 1.28. **Zhvlerësimi**- masën e harxhimit (konsumit), shfrytëzimit të aseteve gjatë periudhës së jetëgjatësisë së tyre ekonomike;

KREU II:
POLITIKAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

Neni 4
Politikat Tarifore

1. Tarifat e shërbimit për furnizim të ujit, shërbimet e ujërave të ndotura dhe të furnizimit të ujit me shumicë nuk duhet të jenë diskriminuese. Përveç nëse ndryshe vendoset nga Autoriteti, ofruesit e shërbimeve duhet të përdorin tarifat e njëjta në zonat e tyre të shërbimit.
2. Autoriteti mund të përcaktojë tarifa zonale nëse e konsideron të arsyeshme, për raste specifike, me një vendim brenda rajonit të caktuar të shërbimit, pa i ndikuar tarifat ekzistuese të pjesës tjetër të rajonit përkatës.
3. Tarifat për shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë, duhet të përcaktohen në bazë të kostove aktuale të furnizimit tek secili ofrues i shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.
4. Tarifat duhet të përcaktohen në bazë të të hyrave të gjeneruara, të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e ofruesit të shërbimeve, në përputhje me legjislacionin aktual dhe kontabilitetin rregullator.
5. Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë nga Autoriteti përdorim të tarifave të ndryshme të shërbimit brenda zonës së tij, duke arsyetuar kërkesën. Autoriteti duhet të përgjigjet me shkrim brenda njëzet (20) ditëve të punës nga data e pranimit të kërkesës.
6. Tarifat për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura duhet të përfshijnë jo më shumë se tri kategori të Konsumatorëve:
 - 6.1 konsumatorë Shtëpiak;
 - 6.2 konsumatorë Komercial/Industrial;
 - 6.3 konsumatorë Institucional;
7. Konsumator i ujit me shumicë është kategoria e veçantë e konsumatorëve.
8. Objektet administrative të njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shoqatave vullnetare të zjarrfikjes faturohen sipas tarifës për konsumatorë shtëpiak.
9. Njësia për Zjarrfikje dhe Shpëtim në rastet e intervenimeve ka të drejtë të shfrytëzojë ujin nga të gjitha burimet e ofruesve të shërbimeve pa kompensim në përputhje me Ligjin për Zjarrfikje dhe Shpëtim.

Neni 5

Parimet/kushtet për përcaktimin e tarifave

1. Autoriteti duhet të përpilojë politikat tarifore për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura dhe furnizim të ujit me shumicë duke u mbështetur në parimet:
 - 1.1. Të gjitha obligimet ligjore që kanë të bëjnë me përcaktimin e tarifave të shërbimit;
 - 1.2. Përgjegjësinë sociale dhe rolin e ofruesit të shërbimeve, si:
 - 1.2.1. njëjtësia e tarifave në zonat e shërbimit;
 - 1.2.2. kategori të ndryshme të konsumatorëve, qasja kufizuese e tyre dhe kostot përkatëse të tyre;
 - 1.2.3. strukturat e tarifave, përfshirë tarifën mujore fikse dhe tarifën volumetrike(vëllimore);
 - 1.2.4. nivelet e shërbimit;
 - 1.3. Taksat e lidhjeve/ri-lidhjeve dhe përshtatshmërinë e kontributeve ndaj investimeve kapitale;
 - 1.4. Mjedisin, duke respektuar:
 - 1.4.1. përshtatshmërinë e strukturës tarifore për menaxhimin e kërkesës dhe taksat për marrjen e ujit të papërpunuar dhe shkarkimin e ujërave të ndotura;
 - 1.4.2. caqet për reduktimin e humbjeve të ujit;
 - 1.4.3. detyrimi mjedisor për kujdesin dhe pajtueshmërinë me standardet e mjedisit;
 - 1.5. Mbulimin e kostos, si:
 - 1.5.1. kostot operative dhe pritjet e efijencës;
 - 1.5.2. mbulimi i shpenzimeve të investimeve kapitale;
 - 1.6. Financimin, strukturën e kapitalit dhe kthimin në kapital;
 - 1.7. Procesin e shqyrtimit të tarifave;
 - 1.8. Çfarëdo qëndrimi tjetër të politikës tarifore siç përcaktohet nga Autoriteti.

Neni 6

Konsultimi, publikimi dhe rishikimi i politikave tarifore

1. Politikat tarifore do të përpilohen përmes procesit të konsultimit me palët e interesit.
2. Autoriteti do të publikojë politikat tarifore që do të jenë në dispozicion për publikun.
3. Autoriteti duhet të rishikojë politikat tarifore në mënyrë periodike dhe ato mund të ndryshohen në rast të:
 - 3.1. ndryshimeve në politikën qeveritare;
 - 3.2. plotësim-ndryshimi në legjislacionin ekzistues ose kur kërkohen ndryshimet e politikave tarifore me legjislacion;
 - 3.3. në rast të mospërbushjes së pritshmërive nga politikat ekzistuese tarifore.

Neni 7

Procedurat për përcaktimin e tarifave

1. Autoriteti duhet të përgatis për secilin shqyrtim periodik të tarifave një pako të procedurave për tarifat e shërbimit me ujë, që:
 - 1.1. ofrojnë koncepte të përgjithshme të procesit për përcaktimin e tarifave për periudhën e ardhshme të shqyrtimit;
 - 1.2. përshkruajnë modelin financiar që do të përdoret në proces;
 - 1.3. përshkruajnë në detaje komponentët individuale të modelit për përcaktimin e tarifave duke përfshirë:
 - 1.3.1. parashikimet e shitjeve të llogaritura;
 - 1.3.2. kostot operative;
 - 1.3.3. kostot e mirëmbajtjes kapitale;
 - 1.3.4. kthimin në kapital (përfshirë definimin e bazës rregullatore të asetëve);
 - 1.3.5. financimet jo tarifore;
 - 1.3.6. procesin e llogaritjes së tarifave;
 - 1.3.7. procesin e përshtatjes ('zbutjes') kur është nevoja;
 - 1.3.8. rregullat e indeksimit për korrigjimet e ndërmjetme, përfshirë:
 - 1.3.8.1. efikasitetin e ofruesit të shërbimeve;
 - 1.3.8.2. shpenzimet e ofrimit të lidhjes;
 - 1.3.8.3. mjaftueshmërinë e tarifës për shërbimet e ofruara;
 - 1.3.8.4. përgjegjësia e institucioneve qeveritare;
 - 1.3.8.5. nevoja e parashikimit të një tarife bazë për shërbime;
 - 1.3.9. Hollësitë tjera, siç përcaktohen nga Autoriteti.

Neni 8

Faturimi i konsumatorëve

Të gjitha kategoritë e konsumatorëve duhet të faturohen sipas legjislacionit në fuqi, të miratuar nga Autoriteti.

Neni 9

Kostot operative

1. Autoriteti përmes procesit tarifor i aprovon ofruesit të shërbimeve kosto optimale, e cila iu mundëson atyre të ofrojnë shërbime cilësore ndaj konsumatorëve dhe njëherësh të ruajnë stabilitetin financiar.
2. Aty ku është e mundur, Autoriteti do të aplikojë standarde apo korniza për kostot operative, duke i sjellë ofruesit e shërbimeve në rrafshin e njëjtë të krahasimit.
3. Autoriteti ka të drejtë të bëjë ndërhyrje në tarifa, nëse gjatë procesit tarifor kostot e planifikuara nuk janë realizuar.

KREU III
INVESTIMET KAPITALE DHE RAPORTIMI
Neni 10

Stimulimi i ofruesve të shërbimeve përmes investimeve kapitale

1. Autoriteti aprovon dhe e mbikëqyrë nga afër realizimin e investimeve kapitale të ofruesve të shërbimeve nga burimet e vetë financimit. Në rast kur nuk janë përmbushur investimet kapitale, Autoriteti aplikon procedura për rishikime periodike të tarifave të shërbimeve:
 - 1.1. Në rastin kur janë realizuar investimet kapitale sipas vlerave të aprovuara, bëhen përshtatjet inflatore.
 - 1.2. Në rast të mos realizimit të investimeve kapitale, Autoriteti ndërmerr veprime korigjuese në tarifa në kundërvlerë të mos përmbushjes së caqeve.
 - 1.3. Në rastin kur vlera e mos përmbushjes është e barasvlershme me inflacionin nuk aplikohen përshtatjet inflatore.
 - 1.4. Autoriteti ka të drejtën e caktimit të minimumit dhe maksimumit të investimeve gjatë përcaktimit të tarifave, duke pasur për bazë ruajtjen e nivelit të shërbimit si dhe përballueshmërinë tarifore.
 - 1.5. Ofruesi i shërbimeve duhet t'i ofrojnë Autoritetit një program investiv, te detajuar dhe në harmoni me planet strategjike.
 - 1.6. Aprovimi i investimeve nga tarifat, bëhet pasi të jenë ofruar prej ofruesit të shërbimeve dokumentet e kërkuara, të cilat përmbajnë llogaritjet dhe afatet kohore për realizim, që rezultojnë të arsyeshme pas analizave të bëra nga Autoriteti.

Neni 11

Ndikimi i investimeve në tarifa dhe niveli i shërbimit

1. Norma e rikthimit në kapital do të rivlerësohet në çdo proces tarifor, mbështetur në bazën e një analize profesionale, që do të siguronte nivelin e duhur të shërbimit;
2. Në rast të dështimit të ofruesit të shërbimeve, në realizimin e investimeve kapitale prej burimeve të vetë financimit, Autoriteti për vitin pasues përmes Urdhëresës Tarifore të Shërbimeve, i bën korigjimet e duhura, në kundërvlerë me kërkesën për të hyra.
3. Për ta ruajtur nivelin e shërbimit, Autoriteti bënë analizë profesionale, të cilën e diskuton gjerësisht me ofruesit e shërbimeve dhe në procesin tarifor vendos për njërin nga parametrat e nevojshëm të investimeve;
 - 3.1. Parametri i investimeve të nevojshme, bazuar në një koeficient, i cili shumëzohet me vlerën e bazës rregullatore të aseteve të shërbimeve përkatëse;
 - 3.2. Parametri i investimeve të nevojshme, i përcaktuar si koeficient në vlerë financiare, i shumëzuar për numrin e konsumatorëve të shërbimeve përkatëse.
 - 3.3. Parametri miks i të dy opsioneve;

Neni 12
Raportimi

1. Ofruesit e shërbimeve duhet t'i raportojnë Autoritetit për ecurinë e aseteve, me të dhënat përcjellëse:
 - 1.1. Stacionet e pompave;
 - 1.2. Rezervuarët dhe
 - 1.3. Burimet ujore.
2. Autoriteti në baza vjetore përcjell, evidenton dhe e rishikon gjatësinë e rrjetit të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, të cilat të dhëna janë të rëndësishme për proceset tarifore.

KREU IV
MENAXHIMI I HUMBJEVE TË UJIT

Neni 13

Stimulimi i zvogëlimit të humbjeve

1. Autoriteti humbjet e ujit i vlerëson si diferencë në mes të ujit të prodhuar dhe ujit të faturuar.
2. Humbjet e ujit evidentohen si humbje teknike (reale) dhe komerciale (aparente). Autoriteti konsiston që:
 - 2.1. Humbjet teknike të ujit t'i zvogëlojë apo t'i eliminojë në saje të politikave stimuluese në investimet në rrjetin e ujësjellësit, duke iu lejuar ofruesve të shërbimeve përtëritje infrastrukturore nga burimet e vetë financimit nga tarifa e shërbimeve deri në nivelin ekonomik të investimit. Përtëritja infrastrukturore ka të bëjë me ndërrimin dhe zëvendësimin e gypave të ujësjellësit.
 - 2.2. Për humbjet komerciale, Autoriteti nuk iu lejon ofruesve të shërbimeve që t'i mbulojnë me tarifën e shërbimit, sepse ato janë produkt i keqpërdorimit të ujit dhe i keq leximit të ujëmatësve. Barrën e keq menaxhimit të humbjeve komerciale e bartin ofruesit e shërbimeve.
 - 2.2.1. Përrjashtim bënë mirëmbajtja kapitale jo-infrastrukturore, e cila nënkupton ndërrimin, zëvendësimin dhe mirëmbajtjen e aseteve mbi nivelin e tokës, e që ka të bëjë me zëvendësimin e ujëmatësve individual, si dhe instalimin e montimin e ujëmatësve zonal.
 - 2.2.2. Për t'i eliminuar keqpërdorimet e ujit të pijshëm, Autoriteti mund t'i mbështesë ofruesit e shërbimeve në pajtim me legjislacionin në fuqi, t'i instalojnë ujëmatësit jashtë oborreve të konsumatorëve,
 - 2.3. Ofruesit e shërbimeve, të cilët i zvogëlojnë humbjet komerciale si rezultat i pajisjeve për zbulimin e rrjedhjeve, do të stimulohen me investime ekuivalente dhe kompensim në përmasa me zvogëlimin e këtyre humbjeve.

Neni 14

Monitorimi i humbjeve të ujit

1. Autoriteti monitoron humbjet e ujit, për të siguruar që humbjet të mbahen në nivelin ekonomik dhe të merren parasysh në strukturën e tarifave.
2. Autoriteti gjatë përcaktimit të tarifave merr parasysh bilancin në mes të shpenzimeve të krijimit të burimeve të reja të ujit dhe shpenzimeve të kontrollit të humbjeve.
3. Autoriteti stimulon ofruesit e shërbimeve përmes përkrahjes së programeve të zvogëlimit të humbjeve të ujit duke iu lejuar investime kapitale ekuivalente me zvogëlimin e humbjeve, si dhe ngritjen e peshës së treguesit gjatë matjes së performancës.
4. Autoriteti do të bëjë analizë të nevojshme para procesit tarifor se a do ta aplikojë një koeficient për lejimin e investimeve kapitale për zvogëlimin e humbjeve, bazuar në Bazën Rregullatore të Aseteve në infrastrukturë dhe jo infrastrukturë.

Neni 15

Kërkesat për të dhëna

1. Autoriteti, në pajtim me procedurat në fuqi kërkon nga ofruesit e shërbimeve të dhëna të nevojshme për përcaktimin e tarifave.
2. Ofruesi i shërbimeve do të sigurojë të dhënat e nevojshme në pajtim me kërkesat për të dhënat brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti.
3. Këto kërkesa për të dhëna kanë të bëjnë me:
 - 3.1. parashikimet e performancës,
 - 3.2. parashikimet e kostove operative;
 - 3.3. shpenzimet kapitale përfshirë mirëmbajtjen kapitale;
 - 3.4. paramasa dhe parallogaria e projekteve të investimeve kapitale;
 - 3.5. zhvlerësimin sipas udhëzimeve të Autoritetit (BRRRA);
 - 3.6. detajet e financimit;
 - 3.7. të dhënat tjera të përcaktuara si të nevojshme për përcaktimin e tarifave.
4. Autoriteti nuk është i obliguar t'i marrë parasysh të dhënat e raportuara nga ofruesit e shërbimeve nëse Autoriteti konsideron që parashikimet e performancës, kostot, investimet dhe burimet e financimit nuk janë reale, atëherë vendos:
 - 4.1. t'i kthej të dhënat ofruesit të shërbimeve për rishqyrtim dhe korrigjim; ose
 - 4.2. të përdor të dhëna alternative të cilat sipas analizave të Autoritetit reflektojnë më mirë performancën e pritur të ofruesit të shërbimeve.

Neni 16
Aplikacioni për Tarifat e Shërbimit

1. Ofruesi i shërbimeve do të dorëzojë aplikacionin për tarifat e shërbimit në pajtim me procedurat, së bashku me të gjitha informacionet mbështetëse, siç është përcaktuar në kërkesat për informacion.
2. Ofruesi i shërbimeve do të sigurojë informacione shtesë për të mbështetur aplikacionin e tarifave të shërbimit, siç kërkohet nga Autoriteti.
3. Aplikacioni i tarifave të shërbimit duhet të aprovohet nga Bordi i Drejtorëve të ofruesit të shërbimeve që dëshmohet me letrën përcjellëse të nënshkruar.
4. Autoriteti mban të drejtën për të përcaktuar tarifat në pajtim me procedurat dhe informacionet e siguruar sipas kërkesës për informacione edhe në rast se ofruesi i shërbimeve nuk e dorëzon aplikacionin formal të tarifave.
5. Nëse ofruesi i shërbimeve nuk i dorëzon të dhënat sipas afateve të kërkuara , Autoriteti do të përcaktojë tarifat e shërbimit bazuar në vlerësimet për kërkesën e të hyrave, nivelin e pritshëm të efijencës dhe performancës operative. Autoriteti bën përshtatjen e tarifave të shërbimit me inflacion, duke rezultuar me një ngritje nominale të tyre, për të kthyer tarifën në vlerë reale.

Neni 17
Shqyrtimi i Aplikacionit

1. Autoriteti do të konfirmojë që aplikacioni i tarifave të shërbimit është në përputhshmëri me kushtet e kësaj rregulloreje, procedurat dhe kërkesat për informacion. Autoriteti do të shqyrtojë dhe të vlerësojë aplikacionin për tarifa të shërbimit, qoftë për ta pranuar apo refuzuar aplikacionin.
2. Autoriteti do të analizojë dhe sfidojë të dhënat e ofrueseve të shërbimit për të siguruar performancë më të mirë.
3. Të dhënat e sfiduara nga Autoriteti duhet të përdoren nga ofruesit e shërbimeve kur ata përpilojnë planet e tyre të biznesit për palët tjera të interesit.
4. Autoriteti duhet të vlerësojë aplikacionin për tarifat e shërbimit në bazë të:
 - 4.1. Përputhshmërisë së tij me procedurat, kërkesat për informacion dhe kërkesat tjera rregullatore;
 - 4.2. Parashikimeve të performancës teknike dhe financiare në të cilat është bazuar aplikacioni për tarifa shërbimi, të cilat do të përmbushin pritjet e Autoritetit, të përmbushjes së caqeve reale dhe për të përcaktuar pritshmërinë e performancës;

- 4.3. Kostove operative të cilat do të reflektojnë përmirësimet sfiduese të efijencës siç është përcaktuar nga Autoriteti;
 - 4.4. Parashikimeve të shpenzimeve për investime kapitale për përmbushjen e standardeve të shërbimit ose niveleve tjera të shërbimit;
5. Gjatë vlerësimit të aplikacionit për tarifa të shërbimit, Autoriteti do të marrë parasysh performancën ekonomike dhe financiare të ofruesit të shërbimeve, duke e krahasuar me performancën e pritur ose aktuale të ofruesve tjerë të shërbimeve. Gjatë këtij krahasimi do të merren për bazë faktorët jo tipik, pengesat topografike, ekonominë e shkallës dhe të ngjashme.

Neni 18

Dokumentet e aplikacionit për shqyrtim

1. Autoriteti gjatë shqyrtimit të aplikacionit, i shqyrton këto dokumente:
 - 1.1. Planet e biznesit;
 - 1.2. Planet e menaxhimit të aseteve;
 - 1.3. Planet afatgjata të investimeve;
 - 1.4. Planet e menaxhimit të thatësisë;
 - 1.5. Planet e furnizimit me ujë në situata emergjente;

Neni 19

Shqyrtimi i Tarifave

1. Tarifat për shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe shërbimeve të furnizimit të ujit me shumicë do të përcaktohen për një periudhë jo më pak se tre vjet dhe jo më shumë se pesë vjet.
2. Autortieti ka të drejtë për rishikim – korrigjim të tarifave të përcaktuara të vitit pasues gjatë periudhës së përcaktuar tarifore tre (3) ose pesë (5) vjeçare, për mos përmbushje të caqeve të përcaktuara me procesin rregullator, posaçërisht në rastet kur dështohet në realizmin e projekteve të investimeve vetjake të aprovuara, e të cilat janë kalkuluar si kosto për tarifë.
 - 2.1 Urdhëresat e Tarifave të Shërbimit (UTSH) do të lëshohen para përmbylljes së vitit aktual, përveç rasteve kur nuk ka mundësi të tillë.
3. Tarifat për furnizim të ujit me shumicë do të përcaktohen për periudhat e ngjashme si për shërbimet e ujësjellësit dhe ujëra të ndotura.
4. Tarifat për secilin vit brenda periudhës së shqyrtimit duhet të përcaktohen paraprakisht në bazë të kostove reale.
5. Tarifat aktuale që do të aplikohen do të jenë të përcaktuara gjatë shqyrtimit shumëvjeçar të

të dhënave të tyre të konsideruara: arritje/ose mos arritje të cagueve të përcaktuara me procesin tarifor të vitit të shikuar dhe të përshtatura/korrigjuara për lëvizjet e përgjithshme inflatore të çmimeve me pakicë, të ndodhura në vitin para procesit të korrigjimit.

KREU V:

DISKUTIMET ME PUBLIKUN

Neni 20

Vendimi për Zhvillimin e Diskutimeve me Publikun

1. Diskutimet me publikun zhvillohen sipas planit të përgatitur nga Departamenti Tarifave, i cili duhet të miratohet me vendimin e Drejtorit të Autoritetit.
2. Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni përcakton:
 - 2.1. Personin përgjegjës i cili i udhëheq diskutimet me publikun;
 - 2.2. Personat e tjerë të ngarkuar për mbarëvajtjen e diskutimeve me publikun;
 - 2.3. Çdo çështje tjetër të përshtatshme.

Neni 21

Organizimi i Diskutimeve me Publikun

1. Autoriteti organizon diskutime me publikun pas dorëzimit të aplikacionit tarifor nga ofruesi i shërbimeve tek Autoriteti dhe para aprovimit të Biznes Planit Rregullator për procesin tarifor tre vjeçar.
2. Autoriteti organizon diskutime me publikun në secilin rajon të ofruesit të shërbimeve, por sipas nevojës mund të organizojnë edhe në komuna të tjera të zonës referuese.

Neni 22

Prezantimi për nivelin e ri tarifor

1. Ofruesi i shërbimeve përgatit një prezantim nga BPRR, që justifikon propozimin për nivelin e ri tarifor që duhet paraqitur gjatë zhvillimit të diskutimit me publikun sipas shtojcës 1 kësaj rregulloreje.
2. Për të garantuar nëse është respektuar formati i prezantimit dhe përmbajtja e tij, ofruesi i shërbimeve duhet ta dërgojë atë paraprakisht për aprovim pranë Autoritetit.
3. Pas aprovimit, prezantimi duhet të jetë i publikuar në ueb faqen e ofruesit të shërbimeve dhjetë (10) ditë para datës së zhvillimit të diskutimit me publikun.

Neni 23

Njoftimi për Diskutimin me Publikun

1. Autoriteti njofton për zhvillimin e diskutimit me publik të paktën dhjetë (10) ditë përpara mbajtjes së tij nëpërmjet njoftimeve të shpallura:
 - 1.1. në ueb faqe zyrtare të Autoritetit;
 - 1.2. njoftimet në ambientet e jashtme të objektit të Autoritetit dhe ofruesit të shërbimeve nëpërmes komunikatës për mediet e shkruara dhe elektronike.
2. Njoftimi duhet të përmbaj informacion mbi datën, orën, vendin dhe qëllimin e zhvillimit të diskutimit me publikun.

Neni 24

Procedurat e Zhvillimit të Diskutimeve me Publik

1. Diskutimet me publik janë të hapura për të gjithë banorët e zonës së shërbimit të ofruesit të shërbimeve dhe të gjitha palët tjera të interesit.
2. Prezantimi i propozimit për tarifa të procesit të ri tre (3) vjeçar bëhet nga përfaqësuesit e ofruesit të shërbimeve.
3. Procesverbali i diskutimit me publik, pavarësisht se regjistrohet apo jo, duhet të mbahet nga personi i autorizuar nga Autoriteti.

Neni 25

Rregullat e Zhvillimit të Diskutimit Publik

1. Gjatë zhvillimit të diskutimit publik, duhet të ruhet etika e komunikimit.
2. Personi drejtues i diskutimit me publik do të sigurojë të drejtën e fjalës për secilën nga palët e pranishme.
3. Drejtuesi i diskutimit publik, duhet të ketë parasysh që pyetjet dhe vërejtjet që vijnë nga publiku shpesh janë të formuluar në mënyra dhe forma që mund të jenë jashtë kontekstit dhe termave që përdoren në menaxhimin e shërbimeve me ujë dhe ujëra të ndotura. Në këtë rast, për të shmangur përplasjet dhe debatet jo konstruktive, duhet bërë kujdes që sqarimi për qytetarët të jetë sa më i thjeshtë dhe i kuptueshëm dhe brenda normave të etikës dhe profesionalizmit.
4. Palët gjatë seancës dëgjimore mund të paraqesin edhe komente me shkrim të cilat administrohen nga Autoriteti.

Neni 26
Transkriptimet

1. Nëse seanca e diskutimit me publik incizohet, çdo deklaratë e bërë gjatë diskutimit transkribohet (zbardhet) në një raport të saktë, pa hequr asgjë, përveç kur personi drejtues urdhëron me shkrim heqjen e shprehjeve eventuale fyese të regjistruara.
2. Çdo korrigjim në transkriptimin e një diskutimi me publik mund të bëhet, vetëm nëse personi drejtues vendos se korrigjimi përputhet me regjistrimin audio ose audio-viziv.

Neni 27
Dokumentacioni

1. I gjithë dokumentacioni i diskutimit me publik, administrohet nga Departamenti i Tarifave të Autoritetit, në dosjen e diskutimit referues me publik.
2. Dosja ruhet komfor legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 28
Raportimi

1. Personi drejtues brenda pesë (5) ditë pune nga përfundimi i diskutimit me publik, përgatit një raport me shkrim lidhur me komentet e marra gjatë diskutimit në fjalë, konkluzionet, rekomandimet dhe ia paraqet drejtorit të Autoritetit.
2. Një kopje e këtij raporti dhe prezantimi i nivelit të ri tarifor arkivohet në Departamentin e Tarifave.

KREU VI:
PROCEDURAT E APROVIMIT DHE KORRIGJIMIT TË TARIFËS

Neni 29
Aprovimi i Tarifave të Shërbimit

Në bazë të kriterëve të vlerësimit të përcaktuar në këtë nen, Autoriteti do të aprovojë me apo pa modifikime aplikacionin për tarifat e shërbimit me shkrim pas lëshimit të urdhëresës për tarifa.

Neni 30

Korrigjimet e rregullta të Tarifave të Shërbimit

1. Tarifat e aprovuara të shërbimit do të aplikohen për periudhën e shqyrtimit të tarifave, të cilat sipas procedurave i nënshtrohen korrigjimeve vjetore në pajtim me rezultatet e shqyrtimit të gjithanshëm të tarifave, për arritje/ose mos arritje të caqeve të përcaktuara për realizim me procesin tarifor të periudhës, e posaçërisht atyre të investimeve kapitale të periudhës së shikuar dhe për lëvizjet inflatore siç është përcaktuar.
2. Në të kundërtën, gjatë periudhës ndërmjet dy shqyrtimeve të proceseve tarifore, tarifat e shërbimit duhet të mbesin të pandryshuara për secilin vit.

Neni 31

Korrigjime të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit

1. Ofruesi i shërbimeve mund të dorëzojë aplikacionin për korrigjime të jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit në pajtim me procedurat.
2. Në rast të rrethanave të paparashikuara gjatë procesit tarifor, ofruesi i shërbimeve mund të dorëzojë kërkesën me shkrim për korrigjim të jashtëzakonshëm. Kërkesa e ofruesit të shërbimeve duhet të ketë të gjitha informatat e nevojshme mbështetëse dhe argumentet bindëse për korrigjim të jashtëzakonshëm. Në rastin kur autoriteti vlerëson se kërkesa i plotëson kriteret e nevojshme për korrigjim të jashtëzakonshëm tarifor, atëherë kërkesa shqyrtohet.
3. Korrigjimet e jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit, kur është nevoja do të bëhen vetëm në fillim të secilit vit, brenda periudhës së shqyrtimit të tarifave, përveç nëse ofruesi i shërbimeve nuk i shpreh Autoritetit nevojën për korrigjimin e tarifës së shërbimit brenda vitit.

Neni 32

Procedurat e Aprovimit për Korrigjimet e Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit

1. Autoriteti do të konfirmojë që kërkesa për korrigjime të jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit është në përputhje me Rregulloren mbi Tarifat e Shërbimit, të vlerësojë dhe të përgjigjet brenda dyzet e pesë (45) ditëve të punës nga data e pranimit të aplikacionit.
2. Autoriteti do të vlerësojë kërkesën për korrigjim të jashtëzakonshëm të tarifave të shërbimit, në pajtim me procedurat e aplikuara.
3. Nëse kërkesa për korrigjim të jashtëzakonshëm i përmbushë kriteret e parapara, atëherë Autoriteti do ta aprovojë atë me shkrim.

Neni 33

Refuzimi i Korrigjimit të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit

1. Autoriteti mund të refuzojë kërkesën për korrigjim të jashtëzakonshëm të tarifave të shërbimit bazuar në:
 - 1.1. dështimin e aplikuesit të sigurojë informacionet e kërkuara brenda afatit të caktuar;
 - 1.2. vlerësimin se kërkesa e aplikuesit nuk është financiarisht e arsyeshme;
 - 1.3. vlerësimin se aplikuesi nuk ka përmbushur standardet minimale të shërbimit;
 - 1.4. dështimin e aplikuesit të kontrollojë kostot operative ose humbjet e ujit ose të dyja.

KREU VII:

MARRËVESHJET PËR TARIFAT E SHËRBIMIT

Neni 34

Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit

1. Autoriteti mund të lidh marrëveshje me shkrim me cilindo ofrues të shërbimeve me qëllim ndryshimi, zëvendësimi ose plotësimi të tarifave të shërbimit të përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje.
2. Marrëveshjet për tarifat e shërbimit mund të lidhen duke dhënë paraprakisht ndonjë kusht të përcaktuar nga Autoriteti i cili i propozohet ofruesit të shërbimeve, duke përfshirë, pa kufizime, lidhjen e marrëveshjeve tjera me ofruesin e shërbimeve mbi:
 - 1.1. nxjerrjen, përtëritjen, zgjerimin, ndryshimin dhe plotësimin e standardeve të shërbimit;
 - 1.2. lëshimin, përtëritjen, vazhdimin, ndryshimin dhe plotësimin e licencës së shërbimit;
 - 1.3. zgjerimin apo zvogëlimin e fushëveprimit territorial të Zonës së Shërbimit;
 - 1.4. zgjerimin, rehabilitimin ose riparimin e rrjeteve të ujësjellësit;
 - 1.5. krijimin, zëvendësimin, zgjerimin, modifikimin dhe/ose plotësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me konsumatorë, siç është përcaktuar në Rregulloren mbi Kartën e Konsumatorëve, të lëshuar, ndryshuar, modifikuar dhe/ose plotësuar nga Autoriteti kohë pas kohe.
3. Për mënjanimin e dyshimit, ofruesit e shërbimeve kanë të drejtë, por jo obligim t'i propozojnë Autoritetit të lidhin marrëveshjen për tarifat e shërbimit, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 35

Negocimi për Marrëveshjen e Tarifave të Shërbimit

1. Ofruesit e shërbimeve të cilët dëshirojnë të lidhin marrëveshje për tarifat e shërbimit duhet të parashtrojnë kërkesë me shkrim Autoritetit, duke kërkuar hapjen e negociatave për të lidhur marrëveshjen e tillë dhe arsyetuar se pse ata konsiderojnë se interesat publike, e drejta e tyre ligjore dhe pritjet e tyre do të përmbushen më mirë nëse Autoriteti pranon të lidh marrëveshje për tarifat e shërbimit.
2. Autoriteti do të përgjigjet me shkrim brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e pranimit të kërkesës së tillë, duke u pajtuar me hyrjen në negociata për lidhjen e marrëveshjes për tarifa të shërbimit ose duke e refuzuar atë.
3. Nëse Autoriteti refuzon të fillojë negociatat për lidhjen e marrëveshjes për tarifat e shërbimit, ai do të tregojë arsyet e refuzimit të tillë.
4. Nëse Autoriteti pranon të fillojë negociata për të lidh marrëveshje për tarifat e shërbimit, ai do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve një periudhë të arsyeshme kohore në cilindo rast, por jo më pak se tridhjetë (30) ditë të punës, për të mundësuar ofruesit të shërbimeve të dorëzojë Autoritetit propozimin e marrëveshjes për tarifat e shërbimit.
5. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës së pranimit të draft marrëveshjes për tarifat e shërbimit, Autoriteti do të njoftoj me shkrim ofruesin e shërbimeve për caktimin e takimit të parë për të negociuar për atë marrëveshje.
6. Autoriteti mund të përcaktojë periudhën maksimale kohore për konkludimin e negociatave për të lidhur Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit, e cila nuk mund të jetë më pak se njëzetë (20) ditë të punës nga data e caktimit të takimit të parë të negociatave.
7. Për mënjanimin e dyshimit, Autoriteti ka të drejtë por jo edhe obligim të lidhë marrëveshje për tarifa të shërbimit, prandaj as refuzimi i tij për të hyrë në negociata për të lidhur marrëveshje ose çfarëdo dështimi për të kompletuar me sukses negociatat, konsiderohen si vendime kontraktuese dhe jo si akte administrative apo vendime që i nënshtrohen ndonjë shqyrtimi administrativ ose gjyqësor.

Neni 36

Lidhja e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit

1. Në rast të konkludimit të suksesshëm nga negociatat e bëra, Autoriteti dhe ofruesi i shërbimeve duhet të lidhin marrëveshje me shkrim për tarifat e shërbimit.
2. Marrëveshja për tarifat e shërbimit duhet të nënshkruhet në gjuhët zyrtare në Kosovë.
3. Në rast të mospërputhshmërisë së versioneve në të cilat nënshkruhet marrëveshja për

tarifat e shërbimit, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotërojë.

4. Përveç nëse ndonjë fakt, informacion ose dokument mund të konsiderohet se përmban ndonjë informacion të privilegjuar ose konfidencial që Autoriteti mund ta arsyetojë me vendim të shkruar, marrëveshja për tarifat e shërbimit, shtojcat e saj dhe të gjitha informacionet e përdorura për negociata dhe lidhjen e marrëveshjes së tillë, do të jetë në dispozicion për publikun me anë të mjeteve të cilat Autoriteti mund t'i përcaktojë kohë pas kohe.

Neni 37

Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit

1. Marrëveshja për tarifa të shërbimit konsiderohet si kontratë për të gjitha qëllimet e synuara ligjore, ku Autoriteti është i obliguar të negociojë, lidh dhe zbatojë marrëveshjen e tillë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Marrëveshja për tarifat e shërbimit ekzekutohet, ndryshohet, zgjerohet, modifikohet, plotësohet, shqyrtohet ose ndërpritet vetëm në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshje dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 38

Pajtuueshmëria me Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit

1. Ofruesit e Shërbimeve janë të obliguar të respektojnë dhe të jenë në përputhshmëri me tarifat e shërbimit të përcaktuara me kushtet e përgjithshme të kësaj Rregulloreje:
 - 1.1. përderisa negociatat për lidhjen e marrëveshjes së tarifave të shërbimit janë në pritje, deri në datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së tillë;
 - 1.2. menjëherë me përfundimin, anulimin, revokimin ose skadimin e marrëveshjes së tarifave të shërbimit, përveç nëse nuk është arritur ndonjë marrëveshje që të mbetet në fuqi, çfarëdo të drejtë dhe obligimi të cilat i përmban marrëveshja për tarifat e shërbimit shfuqizohen për çfarëdo shkak ligjor;
 - 1.3. në të gjitha aspektet kur marrëveshja për tarifat e shërbimit nuk ka përcaktuar ndryshe ose në të gjitha aspektet të cilat nuk i ka paraparë në mënyrë specifike ajo marrëveshje;

**KREU VIII:
PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT**

Neni 39

Prezantimi i tarifave të shërbimit

Ofruesi i shërbimeve do t'i paraqes tarifat e shërbimit ashtu siç janë aprovuar, korigjuar ose rishikuar nga Autoriteti në listën e tarifave të shërbimit që do të përgatitet siç është përcaktuar nga Autoriteti kohë pas kohe.

Neni 40

Publikimi dhe shpërndarja e listës së tarifave të shërbimit

1. Ofruesi i shërbimeve do t'ia shpërndajë secilit konsumator listën e tarifave të shërbimit siç është aprovuar nga Autoriteti, në kohën kur konsumatori lidh kontratë shërbimi ose njëherë në vit t'i bashkëngjis të njëjtën faturës.
2. Tarifat e shërbimit të aprovuara nga Autoriteti do të publikohen nga ofruesi i shërbimeve:
 - 2.1. në gazetën me qarkullim të gjerë në zonën e shërbimit, ku do të aplikohen tarifat e tilla të shërbimit, në ueb faqen e ofruesit të shërbimeve dhe
 - 2.2. publikimet në gazeta do të përsëriten së paku njëherë në javën pasuese kur është bërë publikimi i parë;
3. Ofruesi i shërbimeve do të jetë vet përgjegjës për publikimin dhe informimin publik të tarifave të shërbimit.

KREU IX:

ZBATIMI, RAPORTIMI DHE ANKESAT

Neni 41

Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimit

1. Autoriteti do të monitorojë përputhshmërinë dhe shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me tarifa të shërbimit sipas kësaj Rregulloreje në bazë të:
 - 1.1. Raporteve të dërguara nga ofruesit e shërbimeve, në pajtim me formatin e përcaktuar nga Autoriteti kohë pas kohe;
 - 1.2. Inspektimeve, dhe
 - 1.3. Shqyrtimeve të raporteve të dërguara nga entitetet tjera dhe autoritetet publike.

Neni 42

Raportet dhe mbajtja e shënimeve

1. Secili ofrues i shërbimeve do të përgatis dhe t'i dorëzojë Autoritetit raportet në formën e përcaktuar dhe brenda intervaleve të përcaktuara nga Autoriteti kohë pas kohe.
2. Secili ofrues i shërbimeve do t'i dorëzojë Autoritetit raportet e të dhënave të performancës tre mujore dhe vjetore:
 - 2.1. raportet tre mujore i dërgohen Autoritetit deri më datën 20 të muajit pasues pas përfundimit të tre mujorit;
 - 2.2. raportet vjetore të vitit përkatës i dërgohen Autoritetit deri më datën 31 Mars të vitit pasues;
3. Raportime tjera sipas kërkesave të Autoritetit për shqyrtime dhe analiza eventuale që ndërlidhen me proceset rregullatore.
4. Në bazë të raporteve të dorëzuara nga ofruesit e shërbimeve, Autoriteti përpilon analiza e raporte periodike dhe vjetore me të cilat analizon dhe vlerëson përmbushjen e objektivave të përcaktuara me procesin rregullator të tarifave.
5. Të gjithë regjistrat/shënimet duhet të ruhen nga ofruesit e shërbimeve sipas legjislacionit në fuqi dhe të jenë në dispozicion për shqyrtim/inspektim nga Autoriteti.

Neni 43

Ankesat

1. Ofruesit e shërbimeve mund të parashtrojnë ankesën tek Komisioni Shqyrtues për:
 - 1.1. lëshimin, kufizimin, modifikimin, ndryshimin, plotësimin, përtëritjen e tarifave të shërbimit;
 - 1.2. revokimin, deklarimin e ndërprerjes ose anulimin e cilësdo tarifë të shërbimit të përcaktuar nga Autoriteti sipas kësaj Rregulloreje;
 - 1.3. përcaktimin ose zbatimin e cilitdo prej kushteve të tarifave të shërbimit të parapara me këtë Rregulloreje;
 - 1.4. vënien e çfarëdo gjobe për çfarëdo shkelje të kushteve të tarifave të shërbimit ose për shkeljen e cilësdo dispozitë të kësaj Rregulloreje.
2. Ofruesit e shërbimeve mund të ankohen në gjykatën me juridiksion kompetent për çfarëdo vendimi të marrë nga Komisioni Shqyrtues mbi cilat do vendime konkrete sipas zbatueshmërisë së kësaj rregulloreje në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-042.

KREU X:
DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 44
Gjuha Zyrtare

Kjo rregullore miratohet dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 45
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 07/2016 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë.

Neni 46
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Autoritetit

Drejtori i ARRU

Datë

Raif PRETENI

SHTOJCAT

Tabela 1. Të dhënat operative

Kategoria e të dhënave	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Të dhënat operative					
1.1 Uji i prodhuar	m ³ /vit				
1.2 Uji i humbur	m ³ /vit				
1.3 Uji i humbur në përqindje	%				
1.4 Uji i faturuar	m ³ /vit				
2. Numri i konsumatorëve					
2.1 Shtëpiak	Nr.				
2.2 Komercial/Industrial	Nr.				
2.3 Institucional	Nr.				
Gjithsej:	Nr.				
3. Numri i punëtorëve					
3.1 Shërbimet e ujësjellësit	Nr.				
3.2 Shërbimet e ujërave të ndotura	Nr.				
Gjithsej:	Nr.				
4. Mbulueshmëria me shërbime					
4.1 Ujësjellës	%				
4.2 Kanalizim	%				
4.3 Trajtimit i ujërave të ndotura	%				
5. Gjatësia e rrjetit					
5.1 Rrjeti i ujësjellësit	km				
5.2 Rrjeti i kanalizimit	km				

Tabela 2. Shpenzimet operative

Kategoria e shpenzimeve për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Shërbimet e ujësjellësit					
1.1 Resurse dhe trajtim	€/vit				
1.2 Distribuim	€/vit				
1.3 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura					
2.1 Grumbullimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.2 Trajtimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.3 Trajtimi i llumit	€/vit				
2.4 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				

Tabela 3. Faturimi

Kategoria e faturimit për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifer 1	Viti tarifer 2	Viti tarifer 3
1. Shërbimet e ujësjellësit te konsumatorët					
1.1 Shtëpiak	€/vit				
1.2 Komercial/Industrial	€/vit				
1.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura te konsumatorët					
2.1 Shtëpiak	€/vit				
2.2 Komercial/Industrial	€/vit				
2.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
3. Tarifa fikse					
3.1 Shtëpiak	€/vit				
3.2 Komercial/Industrial	€/vit				
3.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				

Tabela 4. Arkëtimi

Kategoria e arkëtimit për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifer 1	Viti tarifer 2	Viti tarifer 3
1. Shërbimet e ujësjellësit te konsumatorët					
1.1 Shtëpiak	€/vit				
1.2 Komercial/Industrial	€/vit				
1.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura te konsumatorët					
2.1 Shtëpiak	€/vit				
2.2 Komercial/Industrial	€/vit				
2.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				
3. Shkalla e arkëtimit te konsumatorët					
3.1 Shtëpiak	%				
3.2 Komercial/Industrial	%				
3.3 Institucional	%				
Gjithsej:	%				

Tabela 5. Investimet kapitale prej burimeve vetjake

Investimet kapitale vetjake për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Shërbimet e ujësjellësit					
1.1 Resurse dhe trajtim	€/vit				
1.2 Distribuim	€/vit				
1.3 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura					
2.1 Grumbullimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.2 Trajtimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.3 Trajtimi i llumit	€/vit				
2.4 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				

Tabela 6. Investimet kapitale prej donacioneve

Investimet kapitale nga donatorët për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Shërbimet e ujësjellësit					
1.1 Resurse dhe trajtim	€/vit				
1.2 Distribuim	€/vit				
1.3 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura					
2.1 Grumbullimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.2 Trajtimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.3 Trajtimi i llumit	€/vit				
2.4 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				

Tabela 7. Tarifa volumetrike dhe fikse për shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura

Tarifat sipas kategorisë së shërbimeve dhe konsumatorëve	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
Tarifa volumetrike për shërbimet e ujësjellësit					
Shtëpiak	€/m ³				
Jo-shtëpiak	€/m ³				
Tarifa volumetrike për shërbimet e ujërave të ndotura					
Shtëpiak	€/m ³				
Jo-shtëpiak	€/m ³				
Tarifa fikse mujore					
Shtëpiak	€/muaj				
Jo-shtëpiak	€/muaj				

Dinamika e Zhvillimit të Procesit Tarifor tre vjeçar

Duke u bazuar në planin e punës për këtë vit propozohet kjo agjendë për zhvillimin e këtij procesi bazë rregullator të procesit tarifor.

(Sqarimet për shkurtesa; KRU-Kompanitë Regjionale të Ujit, IL-“Ibër-Lepenc’)

Tabela nr. 1

Nr.	Aktiviteti	Bartës	Afati i përmbylljes së aktiviteve
Tarifat e ujit të pa përpunuar me shumicë për IL (për furnizim me ujë të KRU Prishtina dhe KRU Mitrovica)			
1	Ftesa për aplikim për IL për tarifa të rregullta 3 vjeçare 2021-2023	ARRU	15 janar 2020
2	Afati për aplikim të IL me propozime të reja për tarifa shërbimi të, këtij cikli tarifor dhe aprovimi nga ARRU	“Ibër-Lepenc”, ARRU	31 mars 2020
Tarifat për shërbimet e ujit të pijshëm dhe për shërbimet e ujërave të ndotura (Për KRU-t në Kosovë)			
1	Ftesa KRU-ve për aplikim për tarifa të rregullta 3 vjeçare 2021-2023	ARRU	01-10 prill 2020
2	Pranimi i aplikacionit tarifor nga KRU	KRU	30 qershor 2020
3	Procesi i konsultimit rreth aplikacionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të pranuar	ARRU, KRU	maj – qershor 2020
4	Drafti i parë i Biznes Planit Rregullator për KRU	ARRU	30 korrik 2020
5	Diskutimet publike me qytetarë, përfshirë KRU, ARRU dhe palët tjera të interesit	ARRU, KRU	Shtator 2020
6	Finalizimi i BPRR për shtatë KRU dhe dërgimi i BPRR finale tek KRU-të	ARRU	01-10 tetor 2020
7	Ofruesit e shërbimeve i dorëzojnë Planet e Biznesit 2021-2023 të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve në ARRU dhe MZHE	KRU`të	31 tetor 2020
8	Draft Urdhëresat Tarifore të Shërbimit (UTSH) për ofruesit e shërbimit	ARRU	Nëntor 2020
9	UTSH finale për ofruesit e shërbimeve, pas konsultimeve rreth draft tarifave të propozuara	ARRU	01-10 dhjetor 2020